

**PROCESVERBAL NR.1**  
**- Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “IMPIANT I PRODHIMIT TË BRIKET”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Prerëse**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**Fondi limit në TOTAL 11 666 667** (njëmbëdhjetë milion e gjahtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë shtatë) **Lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Kopje te certifikuar te bilancit për vitin financiar 2019,2020,2021, kunukduhettëketërreportnegativndërmjetaktivitdhepasivit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin

**kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.**

2.2.2. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

**Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.**

2.2.3 . Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2022 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “PërSistemin e TaksaveVendore” I ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” I ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” I ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” I ndryshuar.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1. Furnizime te mëparshme të ngjashme në një vlerë jo me te vogel se: 10 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë pese viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Si deshmi per pervojen e meparshme kerkohen te paraqiten:

Vërtetime të ëshuara nga një ent publik përpëmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

ose

Ne rastin e pervojes se meparshme te realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

**Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.**

**Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:**

**Duke qenë se vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar, vlera për furnizime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoje duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës. Per kete arsye eshte kerkuar një ose disa furnzime të ngjashme në vlerën sa 10% e vleres se kontratës.**

**Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.**

- 2.3.2. Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Kamion me vinç me kapacitet mabjtes 10-13 ton ,në pronësi ose me kontratë qiraje noteriale objekt i prokurimi ,shoqeruar me dokumentat si :leje qarkullimi,çertifikata e pronësie,çertifikata e kontrollit teknik,siguracion mjeti i vlefshëm ,raport inspektimi teknik për pajisjen e vinçit,të vlefshëm,foto të mjetit të deklaruar ku të jenë te dukshme targat dhe pajisja vinçit te kamionit
- 2.3.3. Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) trajler (terheqës + rimorkjo) ,në pronësi ose me kontratë qiraje noteriale objekt i prokurimi ,shoqeruar me dokumentat si ,leje qarkullimi,çertifikata e pronësie,çertifikata e kontrollit teknik,siguracion mjeti i vlefshëm ,shoqëruar me foto.
- 2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion provues që disponon në pronësi Impiant i Prodimit të Briket
- a) Fatura tatimore (sipas modelit nga Admnistrata Tatimore ) dhe/ose
  - b) Deklaratë doganore të importit (sipas modelit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë).
- 2.3.5 Autoriteti kontraktor rezervon të drjtën të kryejë verifikimin fizik të impiant i prodimit të Briket me ose pa lajmërim paraprak në çdo kohë.
- 2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë nje deklaratë që merr përsipër vendosjen e impiant të prodimit të Briket në vendin e përcaktuar nga Autoriteit Kontaktor.

**Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si dhe nenit 40, pika 5, gërma ”ç” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.**

**Mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.**

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**